



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KOMISIONERI PËR MBIKËQYRJEN E SHËRBIMIT CIVIL

Nr. 1571/1 Prot

Tiranë, më 05.11.2019

V E N D I M

Nr.119, datë 05.11.2019

“Mbi përfundimin e verifikimit të kryer në institucionin e qeverisjes vendore Bashkia Rrogozhinë, të filluar me urdhrin nr. 65, datë 12.9.2019, të Komisionerit, në lidhje me evidentimin e rasteve të emërimeve në kundërshtim me ligjin në pozicione pune që janë pjesë e shërbimit civil, si dhe zbatimin e standardeve ligjore në strukturimin e shërbimit civil, në përputhje me parimet e ligjit për nëpunësin civil, në këtë bashki”.

Në mbështetje të kompetencave ligjore të parashikuara në pikën 1, të nenit 11, nenet 14 dhe 15, të ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, të ndryshuar, të ligjit nr. 44/2015, “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”, si dhe Rregullores “Mbi procedurat e mbikëqyrjes/inspektimit”, miratuar me vendimin nr. 17, datë 11.3.2015, të Komisionerit për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil, pas shqyrtimit të relacionit dhe mendimit paraprak të Drejtorisë së Përgjithshme të Inspektimit dhe Mbikëqyrjes, në lidhje me verifikimin e kryer në njësinë e vetëqeverisjes vendore Bashkia Rrogozhinë,

VËREJ SE,

Komisioneri për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil, me qëllim mbikëqyrjen e zbatimit të ligjshmërisë në administrimin e shërbimit civil, në lidhje me emërimet në pozicione pune pjesë e shërbimit civil, si dhe zbatimin e standardeve ligjore në strukturimin e shërbimit civil, si pjesë e rëndësishme e strukturës organizative të institucionit, me urdhrin nr. 65, datë 12.9.2019, “Për fillimin e procesit të inspektimit në lidhje me rastet e emërimeve në kundërshtim me ligjin në pozicione pune që janë pjesë e shërbimit civil në njësitë e vetëqeverisjes vendore, si dhe verifikimi i zbatimit të standardeve ligjore në strukturimin e shërbimit civil, si pjesë e rëndësishme e strukturës organizative të institucionit në përputhje me parimet e ligjit për nëpunësin civil”, ka nisur kryesisht procesin e verifikimit në të

gjitha njësitë e vetëqeverisjes vendore (*61 bashkitë e vendit*), ku përfshihet edhe Bashkia Rrogozhinë.

Verifikimi u realizua në përmjet vizitës në subject nga grupi i inspektimit, i autorizuar nga Komisioneri për këtë qëllim. Nga aktet e administruara gjatë inspektimit në subjekt, ka rezultuar se, Bashkia Rrogozhinë, është e organizuar dhe funksionon në bazë të strukturës dhe organikës të miratuar me Vendimin nr. 09, datë 19.1.2019, të Kryetarit të Bashkisë Rrogozhinë, “*Për miratimin e buxhetit të Bashkisë Rrogozhinë për vitin 2019*”, e cila është në fuqi edhe nëmomentin e kryerjes së verifikimit.

Sipas structures aktuale, Bashkia Rrogozhinë, sëbashku me njësitë administrative në përbërje të saj, ka gjithsej **72** pozicione pune të vlerësuara si pjesë e shërbimit civil, të cilat sipas kategorive të shërbimit civil klasifikohen: **1** pozicion i kategorisë së lartë drejtuese **4** pozicione të kategorisë së mesme drejtuese, **14** pozicione të kategorisë së ulët drejtuese dhe **53** pozicione të kategorisë ekzekutive.

Aktualisht institucioni, po punon për hartimin e një strukture të re organizative, përgatitja e të cilës është në proces.

Gjatë procesit të verifikimit në subjekt, u konstatua se, **50** pozicione pune të shërbimit civil, janë plotësuar në zbatim të kërkesave të ligjit nr. 152/2013, “*Për nëpunësin civil*”, të ndryshuar dhe aktet nënligjore në zbatim të tij; **3** pozicione pune të shërbimit civil, rezulton se, janë plotësuar me punonjës të punësuar me akt emërimi të përkohshëm të titullarit të institucionit, në kundërshtim me ligjin; ndërsa **12** pozicione të shërbimit civil rezultuan vende të lira.

Konkretisht, rastet e emërimeve në kundërshtim me ligjin evidentohen si më poshtë, ku specifikohet pozicioni i punës dhe punonjësi që kryen aktualisht detyrën, si edhe akti i emërimit i nxjerrë nga titullari i institucionit:

- ✓ *****, emëruar në pozicionin e punës, Sekretar i Përgjithshëm me aktin nr. 221 datë 03.09.2019.
- ✓ *****, emëruar në pozicionin e punës, Drejtor në Drejtorinë e Shërbimeve Mbështetëse me aktin nr. 171 datë 05.08.2019.
- ✓ *****, emëruar në pozicionin e punës, Përgjegjës në Sektorin e Bujqësisë me aktin nr. 213 datë 02.09.2019.

Komisioneri konstaton se, aktet e emërimit të evidentuara më sipër, kanë dalë në kundërshtim me ligjin, pasi, për çdo marrëdhënie të re pune, që lidhet pas fillimit të efekteve të ligjit nr.152/2013, “*Për nëpunësin civil*”, të ndryshuar, në bazë të nenit 22, 23, 25 dhe 26 të tij, duhet të respektohen detyrimisht kërkesat e një procedure të rregullt

konkurrimi. Çdo emërim që bëhet në kundërshtim me këtë rregull, është absolutisht i pavlefshëm.

Vërejmë se, duke vepruar në këtë mënyrë, titullari i institucionit, ka vepruar në kundërshtim me procedurën e nxjerrjes së aktit, referuar parashikimeve të legjislacionit në fuqi, ç'ka në vështrim të nenit 108, pikat i) dhe ii) të shkronjës “a” dhe shkronjës “ç”, të ligjit nr. 44/2015, “Kodi i Procedurave Administrative i RSH”, i bën aktet absolutisht të pavlefshëm.

Për më tepër, ndalimi i emërimit në kundërshtim me procedurën, është theksuar shprehimisht në pikën 4, të nenit 23, të ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, të ndryshuar, për të mos lejuar subjektivitet apo keqinterpretime në implementimin e kësaj dispozite në praktikë.

Në vijim të këtij arsytimi, në bazë të nenit 110, pika 1, të ligjit nr. 44/2015, “Kodi i Procedurave Administrative i RSH”, veprimi administrativ absolutisht i pavlefshëm nuk sjell asnjë pasojë juridike, pavarësisht faktit nëse është konstatuar apo jo si i tillë.

Vetë organi publik, në këtë rast Kryetari i Bashkisë Rrogozhinë, duhet të konstatojë në këto veprime administrative, ekzistencën e rasteve të parashikuara në nenin 108, të ligjit në fjalë dhe nisur nga detyrimi i parashikuar në nenin 111, të ligjit si më lart, të konstatojë menjëherë pavlefshmërinë absolute të këtyre akteve dhe të rregullojë pasojat duke ndërprerë marrëdhënien e punës të lidhur në kundërshtim me procedurat ligjore dhe më tej, duke i shpallur si të lira këto pozicione, për t'u plotësuar në përputhje me ligjin për nëpunësin civil.

Njësia përgjegjëse, gjatë zhvillimit të procedurave të konkurrit, duhet të kujdeset të përmbushë rregullat e përcaktuara në kreun IV, “Pranimi në shërbimin civil”, të ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, të ndryshuar, vendimin nr. 242, datë 18.3.2015, të Këshillit të Ministrave, “Për plotësimin e vendeve të lira në kategorinë e ulët dhe të mesme drejtuese” dhe vendimin nr. 243, datë 18.3.2015, të Këshillit të Ministrave, “Për pranimin, lëvizjen paralele, periudhën e provës dhe emërimin në kategorinë ekzekutive”, si dhe udhëzimin nr. 2, datë 27.3.2015, të Departamentit të Administratës Publike, “Për procesin e plotësimit të vendeve të lira në shërbimin civil nëpërmjet procedurës së lëvizjes paralele, ngritjes në detyrë për kategorinë e mesme dhe të ulët drejtuese dhe pranimin në shërbimin civil në kategorinë ekzekutive nëpërmjet konkurrit të hapur”.

Duke u nisur nga rrethanat e evidentuara më sipër, njësia përgjegjëse duhet të kujdeset që të realizojë procedurat e rekrutimit në grup, në nivelin ekzekutiv, duke pasur në vëmendje pikën 8, të nenit 19, të ligjit për nëpunësin civil, e cila i klasifikon pozicionet e

punës në grupet e pozicioneve të administrimit të përgjithshëm dhe grupet e pozicioneve të administrimit posaçëm.

Për këto arsye:

Në mbështetje të kompetencave ligjore të përcaktuara në nenin 11, pika 1, nenet 14 dhe 15 të ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, të ndryshuar, referuar Seksionit III, “Procedura hetimore”, të ligjit nr. 44/2015, “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”, si dhe Rregullores “Mbi procedurat e mbikëqyrjes/inspektimit”, miratuar me vendim nr. 17, datë 11.3.2015, të Komisionerit për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil,

V E N D O S A:

1. Të kërkoj nga Kryetari i Bashkisë Rrogzhinë, me synim rregullimin e situatës së ligjshmërisë së administrimit të shërbimit civil, të konstatojë menjëherë, si akte administrative absolutisht të pavlefshëm, rastet e emërimit të punonjësve në kundërshtim me ligjin në pozicione pune që janë pjesë e shërbimit civil, të evidentuara si më poshtë:
 - ✓ *****, emëruar në pozicionin e punës, Sekretar i Përgjithshëm me aktin nr. 221, datë 03.09.2019;
 - ✓ *****, emëruar në pozicionin e punës, Drejtor në Drejtorinë e Shërbimeve Mbështetëse me aktin nr. 171, datë 05.08.2019;
 - ✓ *****, emëruar në pozicionin e punës, Përgjegjës në Sektorin e Bujqësisë me aktin nr. 213, datë 02.09.2019.
2. Të vijojë realizimi i procedurave të konkurrimit për të gjitha vendet vakante të shërbimit civil në kuptim të ligjit, ku përfshihen pozicionet e punës që janë efektivisht të lira si dhe pozicionet e plotësuara në kundërshtim me ligjin në përputhje me strukturën e institucionit në momentin e ekzekutimit të vendimit të Komisionerit.
3. Të përgatitë dhe të miratojë planin e nevojave për rekrutimin në shërbimin civil për vitin e ardhshëm, për të gjitha pozicionet e mbetura vacant deri në shkurt të vitit 2020, duke respektuar procedurat dhe afatet e përcaktuara në vendimin nr. 108, datë 26.2.2014 të Këshillit të Ministrave, “Për planin vjetor të pranimit në shërbimin civil”

4. Të përmbillet procesi i mbikëqyrjes i cili është materializuar me vendimin paralajmërues nr. 188, datë 11.09.2017, të Komisionerit dhe të vijojë rregullimi i situates ligjore në këtë subjekt sipas urdhërimeve të dispozitivit të këtij vendimit.
5. Për kryerjen e këtyre veprimeve administrative, lihet afat **2 (dy) muaj** nga marrja dijani për këtë vendim. Institucioni i inspektuar dhe njësia përgjegjëse, duhet të zbatojnë këtë vendim, duke u bazuar në orientimet e dhëna në pjesën arsyetuese të tij.
Me kalimin e këtij afati, subjekti i mbikëqyrur, njësia e vetëqeverisjes vendore Bashkia Rrogzhinë, duhet të njoftojë me shkrim Komisionerin për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil, në lidhje me zbatimin e këtij vendimi.
6. Në rast të moszbatimit të këtij vendimi paralajmërues, Komisioneri do të vijojë procesin për rregullimin e shkeljeve të konstatuara, sipas parashikimeve të pikës 2, të nenit 15, të ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, të ndryshuar, duke përdorur mjetet ligjore për të rikthyer ligjshmërinë në administrimin e shërbimit civil, nëpërmjet gjobitjes së nëpunësit përgjegjës për moszbatimin e masave të përcaktuara në dispozitivin e vendimit.
7. Për këtë vendim të njoftohet Kryetari i Bashkisë Rrogzhinë, Ministria e Brendshme dhe Prefektura e Qarkut Tiranë. Njësia Përgjegjëse të njoftojë çdo punonjës që është i emëruar në kundërshtim me ligjin dhe që është i evidentuar në këtë vendim.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KOMISIONERI

Pranvera Strakosha